

Data 19.12.2025

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - SHËRBIME

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E TERMAVE TE REFERENCES DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: Vlerësimi teknik në instalimet e Gazsjellësit TAP

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 44161100-7;
71321000-4; 71356000-8; 71356100-9; 71600000-4;

VLERA E FONDIT LIMIT: 17,772,261 (shtatëmbëdhjetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një) lekë pa tvsh dhe/ose 184,054.07 (njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e pesëdhjetë e katër pikë zero shtatë) euro pa tvsh. **Kursi zyrtar i këmbimit i Bankës së Shqipërisë, datë 19.12.2025 është 96.56 lekë/EUR.**

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit është si më poshtë:

Arsyeja kryesore e mosndarjes së procedurës së prokurimit në lote është se referuar preventivit të shërbimeve, termave të references, specifikimeve teknike, Autoriteti Kontraktor e ka të pamundur teknikisht ta ndajë këtë kontratë në lote të veçantë pasi do e bënte shumë të vështirë për tu menaxhuar.

Kjo procedurë shërbimi duhet të kryhet nga një operator ekonomik specifik, pasi lloji i shërbimit për të qenë sa më efikas duhet të jetë i përqëndruar tek një operator ekonomik. Kryerja nga një operator ekonomik e bën më efektiv organizmin e punës por sidomos e bën shumë më të përshtatshëm monitorimin dhe raportimin e të gjitha proceseve të punës që ky shërbim ka.

Përveç arsyeve të listuara më sipër, shërbimet e kërkuara në këtë procedurë janë pjesë e planit të mirmbajtjes së TAP. Ky plan vjen i pandarë e për rrjedhojë edhe procedura e prokurimit duhet të jetë e tillë. Gjithashtu, çdo punonjes i Operatorit Ekonomik që do të shpallet fitues do duhet të marrë trajnimet e nevojshme të sigurojë dhe shëndetin në punë dhe të bëjë ditura rreziqet e impianteve ku do të zhvillohet aktiviteti. Këto trajnime do të zhvillohen nga Autoriteti Kontraktor i cili me pas ngarkon profilin e çdo punonjesi të Operatorit Ekonomik në sistemin elektronik të kualifikimit të TAP (Agora).

Për ndarjen në lote dhe në shumë operatore ekonomik të kësaj procedure do të rriste numrin e personave të cilët aksesojnë impiantet e TAP cka mund të çojë në siguri dhe rrisi rrezikun e ekspozimit të personelit ndaj rrisqeve të impianteve të transmetimit të gazit në presionit të lartë.

Për këtë arsye, është e pamundur që zërat e shërbimeve të ndahen në grupe ose secili, pasi do të vështirësonte realizimin e kontratës, rrjedhimisht nga mundësia e lidhjes së kontratës me disa operatore ekonomikë të ndryshëm.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht:

1. *Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote **sa herë kjo është e mundur**. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve...*

Në rastin konkret, ndarja në lote e procedurës së prokurimit, do të komplikonte menaxhimin e minikontratave, marjen e autorizimeve nga TAP për cdo operator ekonomik dhe shpërndarjen e përgjegjësisë duke e komplikuar realizimin me sukses të kontratës ndaj vlerësohet se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë dhe në përputhje me ligjin e sipërpërmendur.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Albanian Gas Service Company SH.A** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e termave të referencës dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas Shtojcës 10**.
- b. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 3**;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenet 76, 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit”, në nenin 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar si dhe në nenin 30/1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlogaritur të marrëveshjes kuadër.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, në nenin 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore

dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat" të ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto tre vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron.

2.2 Aftësitë teknike:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. ose

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe në nenin 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit të Marrëveshjes kuadër, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën prej 40% të fondit limit të MK, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një tregues thelbësor, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si vërtetime/fatura tatimore për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit (ose ekuivalente me të).

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit ISO 14001:2015, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit (ose ekuivalente me të).

2.2.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë ISO 45001, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit (ose ekuivalente me të).

Të gjitha çertifikatat e mësipërme të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në nenin 79, pika 1 e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe në nenin 44 “Kërkesat e Cilësisë” të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Nisur nga norma ndërkombëtare që përfaqëson ISO-ja 9001:2015 “Sistemi për Menaxhim të Cilësisë”, aplikohet për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar në fushën e inspektimit pavarësisht madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë. Vendosja e ISO 9001:2015 na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, zotësinë e operatorëve ekonomikë për zbatimin e kërkesave të vazhdueshëm të tij për të siguruar konformitetin në zbatimin e kërkesave. Disponimi i kësaj ISO-je rrit kompetivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se është e lidhur ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizon konkurrencën, OE duhet ta paraqesin atë.

Duke qenë se, shërbimet e inspektimit teknik të parashikuara në këtë kontratë do të realizohen në terren përgjatë shtrirjes së taubacionit të gazit TAP, ku ushtron aktivitet AGS sh.a, është e domosdoshme që operatorët ekonomikë ta disponojnë edhe Standartin ISO 14001:2015 “Sistemi menaxhimit të mjedisit”. Kjo ISO është e lidhur me mjedisin dhe ndihmon në përmirësimin e imazhit të shoqërisë në lidhje me klientet e saj, komunitetin dhe autoritetet kontraktore. Në të njëjtën kohë menaxhimi i duhur i çështjeve lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe parandalimin e ndotjeve ndihmojnë në rritjen e konkurrencës së shoqërisë shoqëruar me uljen e shpenzimeve. Angazhimi për mbrojtjen e mjedisit është një kriter madhor në zgjedhjen e një prodhuesi kurse metoda me të thjeshtë dhe me efikasitet për të shfaqur kujdes ndaj problemeve lidhur me mjedisin është zbatimi i një sistemi menaxhimi për mjedisin në konformitet me parashikimet e standartit ndërkombëtar ISO14001. Përfitimet kryesore për këtë sistem menaxhimi janë: paraqitja e angazhimit për mbrojtjen e mjedisit nga klienti, investitorët potencialë, komuniteti, autoritetet; zvogelimin e shpenzimeve nepermjet përmirësimit të administrimit mbeturinave dhe uljen e konsumit të burimeve; parandalimin e incidenteve të mundshme që mund të cojë në pagesën për demshperblim dhe dëm; përmirësimin e marrëdhënieve me autoritetet; mundësi për hyrje në tregje të reja. Për sa më sipër, vendosja e kësaj ISO është në proporcion me objektin që AK po prokuron.

Standarti ISO 45001 përfaqëson një standard ndërkombëtar që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurisë në punë të punonjësve të kompanisë me udhëzime për përdorimin e tij, për të mundur një organizatë që të përmirësojë në mënyrë proaktive performancën e shëndetit dhe sigurisë në punë të punonjësve të saj. Kjo ISO ka për qëllim të jetë e zbatueshme për çdo organizatë përfshirë dhe subjektet tregtare pavarësisht nga madhësia, lloji

dhe natyra e saj. Për më tepër, që në kriteret teknike AK ka kërkuar ndër të tjera që operatorët ekonomikë të disponojnë një staf të caktuar, minimal prej 6 punonjës, të cilët duhet ti sigurojnë AK shërbimin e nevojshëm gjatë gjithë periudhës që do të shtrihet kontrata.

Në këtë kuptim, AK në vendosjen e kriterëve të mësipërme kërkon garanci në lidhje me përmbushjen me sukses dhe në afat të kontratës nga ana e operatorëve ekonomikë, të cilët duhet të dëshmojnë performancën e shëndetit dhe sigurisë në punë të punonjësve të tyre. Në objektin e kontratës janë parashikuar shërbime, të cilat rrezikojnë në mënyrë të vazhdueshme jetën dhe shëndetin e punonjësve që do të angazhohen, kështu që rrjedhimisht kërkesa për këtë certifikatë është një kërkesë e nevojshme.

Gjithashtu argumentojmë se, politikat e AGSco Sh.A. për sigurinë dhe shëndetin në punë kanë një rol thelbësor për të gjitha llojet e aktiviteteve që ushtrohen, kerkese kjo si kontraktuale ndërmjet nesh edhe TAP ashtu edhe ndërmjet nesh edhe të gjithë palëve të treta (sic janë operatorët ekonomikë) që lidhin kontratë me AGSco dhe do të kryejnë aktivitet furnizimi, trajnimi dhe shërbimi.

2.2.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë Certifikatën e Akreditimit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (për të kryer inspektim sipas ISO/IEC 17020:2012 «Kritere të përgjithshme për funksionimin e tipeve të ndryshme të organizmave që kryejnë inspektim » si një organizem Inspektimi i Pavarur i Tipit A në fushat e veprimtarisë si më poshtë:

- Inspektimi periodik dhe vlerësimi i konformitetit në fushën e enëve nën presion.
- Inspektimi periodik dhe vlerësimi i konformitetit të valvulave të sigurisë të presionit
- Inspektimi periodik dhe vlerësimi i konformitetit në fushën elektrike
- Inspektimi periodik dhe vlerësimi i konformitetit në fushën mekanike
 - a. makinerive ngritëse dhe aksesoreve.
 - b. shkallëve dhe platformave
- Vlerësimi i konformitetit të instalimeve ATEX.
- Inspektimi periodik dhe vlerësimi i konformitetit të ashensorëve.
- Inspektimi periodik dhe vlerësimi i konformitetit të litereve së sigurisë për punimet në lartësi.

2.2.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë Akt-Miratimi "Organ i Miratuar i Vleresimit të Konformitetit të TIPI A", në fushat e veprimtarisë si më poshtë:

- Inspektimi periodik dhe vlerësimi i konformitetit në fushën e enëve nën presion.
- Inspektimi periodik dhe vlerësimi i konformitetit të valvulave të sigurisë të presionit
- Inspektimi periodik dhe vlerësimi i konformitetit në fushën elektrike
- Inspektimi periodik dhe vlerësimi i konformitetit në fushën mekanike
 - a. makinerive ngritëse dhe aksesoreve.
 - b. shkallëve dhe platformave
- Vlerësimi i konformitetit të instalimeve ATEX.
- Inspektimi periodik dhe vlerësimi i konformitetit të ashensorëve.

- Inspektimi periodik dhe vlerësimi i konformitetit të litereve së sigurisë për punimet në lartësi.

Argumentimi: Kërkesat në pikat 2.2.5 dhe 2.2.6 janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe në nenin 41, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe të Ligjit nr.10489/2011 “Për mbikqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore” i ndryshuar, të ligjit Nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion”, të ligjit Nr. 8734, datë 1.2.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike” i ndryshuar.

Referuar zerave të shërbimeve në terma të referencës është e domosdoshme që OE të disponojnë këtë dy lloje dokumentesh për të kryer inspektimet me cilësi dhe sipas rregullave që kërkon legjislacioni i fushës përkatëse.

2.2.7 Operatori ekonomik për realizimin me sukses të kësaj kontrate duhet të disponojë në stafin e vet punonjës të kualifikuar minimumi 6 (gjashtë), të cilët duhet të jenë të certifikuar me kualifikimet si më poshtë:

- Inxhinier Elektrik – minimumi 1 (një) i licencuar në OMVK (Organ i Miratuar për Vlerësimin e Konformitetit).
- Inxhinier Mekanik – minimumi 1 (një) i licencuar në OMVK (Organ i Miratuar për Vlerësimin e Konformitetit) të enëve me presion, tubacioneve, pajisjeve ngritëse ose sistemeve mekanike të ngjashme.
- Inspektor NDT (UT/MT/PT/VT – Niveli II) – minimumi 1 (një). Duhet të jetë i pajisur me certifikim të vlefshëm, të lëshuar nga një organ certifikues i akredituar në përputhje me ISO/IEC 17024, plotësisht në përputhje me EN ISO 9712:2021, për metodat e mëposhtme:
 - Testim Ultrasonic
 - Testim me Grimca Magnetike (MT)
 - Testim me Lëng Penetrues (PT)
 - Inspektim Vizual (VT)

Niveli minimal i kërkuar i certifikimit duhet të jetë minimalisht Niveli 2 për secilën metodë të aplikueshme.

- Inspektor Termografie – minimumi 1 (një) i certifikuar sipas ISO 18436:2014 .
- Inspektor ATEX – minimumi 1 (një) i certifikuar sipas SSH EN 60079.
- Person përgjegjës /koordinator HSE, – minimumi 1 (një) i certifikuar nga një trup i akredituar për dhënien e trajnimeve për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Plotësimin e kërkesave të mesiperme, operatori ekonomik duhet ta provojë nëpërmjet dorezimit të këtij dokumentacioni:

- Operatori Ekonomik duhet të paraqesë listë pagesat e tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit si dhe Vërtetim për pagesën e kontributeve të lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve.*
- Për inxhinierët, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Diplomë, Licence, CV.*

- iii. *Për inspektorët NDT, Termografie, ATEX, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë, certifikatat e kualifikimit dhe CV përkatëse.*
- iv. *Për personin përgjegjës/koordinatorin HSE, Certifikatën përkatëse të lëshuar nga institucioni kompetent.*

Shënim:

- *Për pozicionet e Inspektorët NDT, Termografie, ATEX, dhe personin përgjegjës mund të përmbushen edhe nga i njëjti person që plotëson kriteret e kërkuara për këto pozicione.*
- *Certifikatat dhe licencat e kërkuara me sipër duhet të jenë në fuqi në momentin e dorëzimit të ofertës. Në rast se ndonjë certifikatë skadon gjatë periudhës së kontratës, operatori ekonomik fitues është i detyruar të sigurojë rinovimin e saj në kohë, në mënyrë që personeli i angazhuar të mbetet i certifikuar gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas Shtojces 10 të DT. Ndërsa dokumentat e kërkuara në këtë kriter do të paraqiten nga OE i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit sipas percaktimeve të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Argumentimi: Vendosja e këtij kriteri bazohet në pikën 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe në nenin 41, pikat 4/b) dhe 4/c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, të cilat na japin të drejtën të përcaktojmë kriteret për kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë, në funksion të natyrës, kompleksitetit dhe rrezikut të shërbimeve që prokurohen.

Kriteri është vendosur gjithashtu në përputhje me legjislacionin shqiptar që rregullon fushën e inspektimit teknik, sigurisë industriale dhe konformitetit, përfshirë Ligjin nr. 10489/2011 “Për mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo-ushqimore”, i ndryshuar; Ligjin nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion”; Ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike”, i ndryshuar si dhe aktet nënligjore dhe standardet teknike të zbatueshme në fuqi.

Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë staf të mjaftueshëm, të kualifikuar dhe të certifikuar, i cili është i domosdoshëm për realizimin e kontratës në përputhje me kërkesat ligjore dhe teknike. Kërkesa për minimumi 6 (gjashtë) punonjës është përcaktuar duke marrë në konsideratë shtrirjen gjeografike të infrastrukturës, numrin e impianteve dhe mundësinë e kryerjes së inspektimeve paralelisht në disa objekte (Korçë, Corovode dhe Fier).

Shërbimet që prokurohen lidhen me inspektime teknike të karakterit elektrik, mekanik, instrumentues dhe strukturor në infrastrukturën e transmetimit të gazit natyror, e cila operon me presion të lartë deri në 95 bar dhe përfshin stacione të valvulave të bllokimit, stacionin e matjes dhe filtrimit të gazit, si dhe stacionin e kompresorëve. Këto impiante klasifikohen si objekte me rrezik të lartë teknik, ndaj kryerja e inspektimeve kërkon personel me kualifikime të specializuara dhe të certifikuara.

Për këtë arsye, është kërkuar prania në staf e inxhinierëve elektrikë dhe mekanikë të licencuar nga Organ i Miratuar për Vlerësimin e Konformitetit (OMVK), të cilët janë kompetentë për kryerjen e inspektimeve rregullatore në instalime elektrike, enë nën presion, tubacione, pajisje ngritëse dhe sisteme mekanike të ngjashme, në përputhje me kërkesat e legjislacionit përkatës.

Gjithashtu, një pjesë thelbësore e shërbimeve të prokuruar përfshin testime pa shkatërrim (NDT) për inspektimin e saldimeve të reja dhe të riparuar, si dhe për vlerësimin e gjendjes së strukturave ekzistuese dhe parashikimin e jetës së shërbimit të pajisjeve nën presion dhe tubacioneve. Referuar standardeve të zbatueshme, këto inspektime duhet të kryhen nga inspektorë NDT të certifikuar sipas EN ISO 9712, ndaj është kërkuar minimalisht një inspektor NDT Niveli II për metodat UT/MT/PT/VT.

Në funksion të inspektimeve preventive dhe diagnostikuese, kriteri parashikon edhe inspektor të certifikuar për termografi, në përputhje me ISO 18436, për identifikimin e anomalive termike në pajisjet elektrike dhe mekanike, si dhe inspektor ATEX, i certifikuar sipas SSH EN 60079, për garantimin e sigurisë në ambiente me atmosferë potencialisht shpërthyes.

Për më tepër, duke qenë se shërbimet do të realizohen në impiante industriale aktive, është kërkuar prania e një personi përgjegjës / koordinatori HSE, të certifikuar sipas legjislacionit shqiptar për sigurinë dhe shëndetin në punë, me qëllim koordinimin, monitorimin dhe zbatimin e masave të sigurisë gjatë gjithë periudhës së kontratës.

Përcaktimi që disa prej këtyre roleve mund të përmbushen edhe nga i njëjti person, me kusht që ai të zotërojë certifikimet përkatëse, është bërë për të garantuar proporcionalitetin e kriterit dhe për të mos kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Në këtë kuadër, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kriteri i mësipërm është i domosdoshëm, proporcional dhe i justifikuar, dhe synon të garantojë realizimin e sigurt, cilësor dhe në përputhje me legjislacionin e shërbimeve të prokuruar, si dhe mbrojtjen e sigurisë së impianteve dhe të punonjësve që operojnë dhe i mirëmbajnë ato.

2.2.8 Operatori ekonomik për realizimin me sukses të kontratës duhet të disponojë minimimi mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike në pronësi ose me qira sipas tabelës më poshtë:

Nr	Instrument	Sasia min. ne cope
1	Multimetër digjital (TRMS) për matje të përgjithshme elektrike në instalime industriale	2
2	Ampermetër me kapëse (TRMS) për matje të rrymës AC/DC në instalime industriale	2

3	Testues i rezistencës së izolimit (Megohmetër) për inspektime teknike të instalimeve elektrike	1
4	Megohmetër për tensione të larta për testimin e izolimit të transformatorëve dhe kablllove të tensionit të mesëm (MV)	1
5	Pajisje për matjen e rezistencës së tokëzimit për instalime elektrike industriale	1
6	Testues i impedancës së qarkut (loop impedance) për verifikimin e qarkut të shkurtër	1
7	Kamerë termike digjitale për inspektime teknike dhe matje temperature	1
8	Testues i instalimeve elektrike për RCD (AC/A/F/B/B+)	1
9	Kalibër (Vernier Caliper) për kontrolle dimensionale gjatë inspektimeve teknike	1
10	Bankoprovë për testimin e valvulave të sigurisë të enëve dhe instalimeve nën presion	1
11	Manometër presioni për inspektime të enëve dhe instalimeve nën presion	1
12	Manometër digjital presioni për inspektime teknike të enëve dhe instalimeve nën presion	1
13	Sensor ngarkese (Load Cell) për verifikimin e kapacitetit të pajisjeve ngritëse (ATEX)	1
14	Matës ultrasonik i trashësisë për testime jo shkatërruese (NDT)	1
15	Detektor ultrasonik i defekteve për testime jo shkatërruese (NDT)	1
16	Detektor gazi ATEX për monitorimin e atmosferave shpërthyes	2
17	Pajisje për testim radiografik (RT) për testime jo shkatërruese (NDT)	1

18	Matës i pikës së vesës / RH për kontrollin e kushteve ambientale	1
19	Set testimi për kripërat e tretshme për kontrollin e ndotjes së sipërfaqeve metalike	1
20	Testues TTR për verifikimin e raportit të spiralave të transformatorëve	1

Shënim: Pajisjet e matjes dhe testimit që përdoren për kryerjen e inspektimeve teknike dhe që japin vlera matëse duhet të jenë të kalibruara dhe funksionale. Kalibrimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e përdorimit dhe i kryer në përputhje me kërkesat e prodhuesit dhe/ose standardet përkatëse të aplikueshme.

Për pajisjet që nuk kërkojnë kalibrim formal, operatori ekonomik duhet të sigurojë që ato të jenë të verifikuara dhe të përshtatshme për përdorim, sipas udhëzimeve të prodhuesit.

Pajisjet që përdoren në zona me rrezik shpërthimi ose për monitorimin e atmosferave shpërthyes duhet të jenë në përputhje me kërkesat ATEX (EN 60079).

Plotësimin e kërkesave të mesiperme, operatori ekonomik duhet ta provojë nëpërmjet dorezimit të dokumentacionit si faturat e blerjes ose kontratën e qirasë.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e mjeteve dhe pajisjeve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 10 të DT. Ndërsa dokumentat e kërkuara në këtë kriter do të paraqiten nga OE i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit sipas percaktimeve të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Argumentimi: Vendosija e këtij kriteri bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën

Argumentimi për kërkesën e pajisjeve të inspektimit teknik (me referencë sipas numrave rendorë)

Kërkesa për disponimin e pajisjeve dhe instrumenteve të mëposhtme është përcaktuar në funksion të natyrës së shërbimeve të inspektimit teknik, kompleksitetit të impianteve të transmetimit të gazit natyror dhe nivelit të rrezikut teknik dhe operacional që lidhet me këto impiante.

Pajisje për sistemet elektrike dhe sigurinë elektrike nga Nr. 1–8 janë të domosdoshme për kryerjen e inspektimeve të sigurisë elektrike në instalime industriale, përfshirë verifikimin e izolimit, tokëzimit, mbrojtjes nga kontaktet indirekte, funksionimit të pajisjeve mbrojtëse dhe identifikimin e defekteve elektrike ose mbinxehjeve. Inspektimet elektrike janë kritike për funksionimin e sigurt të stacioneve të kompresorëve, stacioneve të matjes dhe filtrimit si dhe stacioneve të valvulave të bllokimit.

Pajisje për inspektime mekanike dhe dimensionale Nr. 9 dhe Nr. 13 do të përdoren për kontrollin dimensional të elementeve mekanike dhe për verifikimin e kapacitetit dhe sigurisë së pajisjeve ngritëse. Ato janë të nevojshme për të garantuar përputhshmërinë mekanike të komponentëve, si dhe për të parandaluar rreziqet që lidhen me ngritjen dhe manipulimin e pajisjeve të rënda gjatë punimeve në impiante.

Pajisje për inspektimin e enëve dhe instalimeve nën presion nga Nr. 10–12 janë të domosdoshme për verifikimin e funksionimit korrekt të valvulave të sigurisë dhe për kontrollin e presioneve në enë, tubacione dhe instalime nën presion. Duke qenë se infrastruktura e transmetimit të gazit natyror operon me presione të larta, inspektimet e këtij lloji janë thelbësore për garantimin e sigurisë teknike dhe parandalimin e incidenteve serioze.

Pajisje për testime jo shkatërruese (NDT) Nr. 14, 15 dhe 17 janë të nevojshme për inspektimin e tubacioneve, saldimeve dhe elementeve metalike pa dëmtuar materialin. Ato shërbejnë për identifikimin e defekteve të brendshme, matjen e trashësisë së mureve dhe vlerësimin e integritetit strukturor dhe jetëgjatësisë së shërbimit të impianteve kritike të transmetimit të gazit natyror.

Pajisje për siguri, ATEX dhe monitorim të kushteve mjedisore Nr. 16, 18 dhe 19 do të përdoren për monitorimin e atmosferave potencialisht shpërthyes, garantimin e kushteve të sigurta të punës dhe kontrollin e kushteve ambientale gjatë punimeve të veshjes mbrojtëse dhe menaxhimit të korrozionit. Përdorimi i tyre kontribuon drejtpërdrejt në mbrojtjen e personelit, sigurinë e impianteve dhe rritjen e jetëgjatësisë së tubacioneve.

Pajisje specifike për transformatorët Nr. 20 është e nevojshme për verifikimin e raportit të spiralave të transformatorëve dhe për vlerësimin e gjendjes së tyre funksionale. Testimi TTR është pjesë e inspektimeve teknike për garantimin e funksionimit të sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemeve elektrike të fuqisë në impiantet industriale.

Për sa më sipër, kërkesa për pajisjet e listuara sipas numrave rendorë vlerësohet e domosdoshme, proporcionale dhe e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, me qëllim garantimin e sigurisë teknike, funksionimit të qëndrueshëm të impianteve dhe përmbushjen e kuadrit rregullator shqiptar dhe standardeve ndërkombëtare të aplikueshme.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.2.9 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se do zbatojë rregullat e percaktuara në Kodin e Etikës të AGS SH.A lidhur me realizimin e objektit të kësaj kontrate. (ky kod është i publikuar në SPE se bashku me DT).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 41/6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar ku parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

AGS SH.A është një shoqëri shërbimesh operative, përgjegjëse për kryerjen e veprimtarisë së mirëmbajtjes dhe shërbimeve teknike për Trans Adriatic Pipeline AG sipas Marrëveshjes së Mirëmbajtjes midis Trans Adriatic Pipeline AG dhe AGSco. Ndaj AGSco në marrëdhëniet me

biznesin, bazohet dhe ndjek parimet e besnikërisë, korrektësisë, transparencës, efikasitetit dhe tregut te lire, parime këto të përcaktuara jo vetëm në legjislacionin e prokurimit por edhe në Kodin e Etikës të shoqërisë. Në këtë Kod janë përcaktuar edhe rregullat mbi (praktikat korruptive, favoret e paligjshme, marrëveshjet e fshehta dhe kërkesat për përfitime personale për veten ose te tjerët etj.), që grupet e interesit (përfshirë ofertuesit) duhet t'i vlerësojnë nëse ato kërkojnë të bashkëpunojnë me AGS SH.A, prandaj përpara se operatorët ekonomikë të ofertojnë duhet të njihen dhe marrin përsipër t'i zbatojnë këto rregulla. Për më tepër, argumentojmë se këto rregulla nuk bien ndesh me rregullat e prokurimit publik, prandaj është vlerësuar nga ana jonë edhe vendosja e kriterit se operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë se do zbatojë rregullat e përcaktuara ne Kodin e Etikes të AGS SHA qe kane lidhje me realizimin e objektit te kësaj kontrate.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit Shtojca Nr.10 dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s'kualifikimi.

Referuar nenit 82, pika 4 e ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 për “Prokurimin publik” “Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë”, si dhe Nenit 26, pika 6, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, “Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.”

Të gjitha dokumentet duhet të jenë ne gjuhen shqipe ose angleze origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i termave të referencës

Termat e references janë hartuar nga grupi i punes duke marrë në konsideratë planin e mirëmbajtjes së Klientit tonë TAP si dhe nevojat e Autoritetit Kontraktor, lidhur me te dhena teknike specifike per shkak te sherbimeve qe do te kryejne si dhe afatin kohor për realizimin e këtij sherbimi nga data e lidhjes se marreveshjes kuader deri me 31.12.2026. Hartimi i termave te references eshte bere ne perputhje me percaktimet e nenit 36 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Duke marre parasysh qe afati i kësaj marreveshje kuader është deri me 31.12.2026 per shkak se edhe kontrata e Autoritetit Kontraktor me klientin tone TAP perfundon me date 31.12.2026, Autoriteti Kontraktor eshte i detyruar te realizoje shërbimin e vlerësimit teknik në instalimet e gazsjellësit TAP. Të gjitha shërbimet dhe pajisjet e kerkuara ne termat e references janë hartuar bazuar ne kërkesat funksionale te shërbimit te mirembajtjes se aseteve te TAP .

Me kërkesë të klientit tonë TAP, gjithashtu është kërkuar në termat e references qe operatori ekonomik fitues duhet të sjellë para nënshkrimit të kontratës, siguracionin e pergjegjesise profesionale ne vleren 100,000 Euro, si siguri per asetet e veta dhe per sa kohe parashikohet ne ligj.

“Albanian Gas Services Company” Sh.A është një shoqëri aksionare me kapital italo-shqiptar dhe kryen shërbimet për mirëmbajtjen e rrjetit të transmetimit te gazsjellesit të ndërtuar nga TAP në territorin e Republikës së Shqipërisë në zbatim të marrëveshjes ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Trans Adriatic Pipeline AG (TAP).

Bazuar në nenin 41 pika 6 të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, **në kërkesën e Klientit tonë TAP, ku kërkohet niveli minimal prej 100,000 Euro**, si dhe në aktivitetin qe AGS sha kryen, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të përcaktojë në DT kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Në nenin 14, Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale, të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës të DST përcaktohet shprehimisht se:

Furnizuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për profesionin për ta zhdëmtuar Blerësin për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.

Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Furnizuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithësi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen.

Për sa më sipër, AK ka përcaktuar në DT, Sigurimin e Përgjegjësisë ndaj Palëve të Treta për ta mbajtur Kontraktorin të kompensuar nga çdo humbje, dëmtim, kosto etj., në lidhje me çdo lëndim të çdo personi dhe çdo dëmtim të pronës për një vlerë prej 100,000 euro.

Duke qenë se, nuk ka ndonje ligj apo akt nënligjor që të përcaktojë saktësisht se sa duhet të jetë vlera minimale apo max. e këtij siguracioni, AK ka vlerësuar t’i kërkojë operatorit ekonomik fitues përpara fillimit të zbatimit të kontratës, siguracionin e përgjegjësisë profesionale në vlerën prej 100,000 euro (si police sigurimi), duke bërë një analizë të treguesve si kostoja e lartë e aseteve të

saj ku do të kryhen shërbimet dhe rreziku i lartë që merr në konsideratë aktiviteti i AGS sha. Rreziku i punës në tubacione gazi është tepër i lartë për pasojë të rrjedhjes së gazit, shpërthimeve, dëmtimeve të njerëzve, të pronës, mjedisit, etj. Theksojmë se pavarësisht vlerës që është vendosur, primi i sigurimit për tu pajisur me këtë policë të llogaritur nga shoqëritë e sigurimeve është në vlerë të vogël dhe të përballueshme nga Furnizuesi që për sa kohë merr përsipër të realizojë kontrata të kësaj fushe. Ky sigurim do të shërbejë për të zhdëmtuar Blerësin për çdo gabim në mos ndjekjen e procedurave të sigurisë, për çdo inspektim të bërë keq, për çdo veprim apo mosveprim profesional që çojnë në humbje, në dëme potenciale proneje, kosto të tjera, të rezultuara nga mangësitë e Furnizuesit gjatë kryerjes së shërbimeve kontraktuara. Nëpërmjet kësaj police Furnizuesi ka detyrim profesional por edhe ligjor të mbrojë veten nga rreziqet e punës, Blerësin nga dëmet e mundshme dhe të garantojë që ka kapacitet të përballojë dëmet në rast incidenti.